

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Pogradec, më 26.11.2019

Për: *Operatorin Ekonomik REJ SHPK me numër NIPT: J93711608Q* dhe adresë sipas ekstraktit të QKB-së "Fshati Udenisht, ambient me numer pasurie 203/1, zona kadastrale 3665, Pogradec".

Procedura e prokurimit: **E Hapur" - "Punë" -"Prokurim elektronik"**

Numri i referencës së procedurës: **REF-35204-09-06-2019.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Me objekt **"Rehabilitim/perforcim banesash ekzistuese" dhe kohëzgjatje 6 (Gjashtë) muaj.**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 37, datë 16 Shtator 2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët X

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. B.O.E "ADA – CO" SHPK, Nipt: K64112603J & "KUARCI BLACË" SHPK NIPT: K24207608A.

Vlera e ofertës pa TVSH: **22 812 818** (Njëzet e dy milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

2. "AURORA KONSTRUKSION" SHPK NIPT: K0201700I

Vlera e ofertes pa TVSH: **19 794 918** (Nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

3. "ELDA – VL" SHPK NIPT: K67106202Ë

S'ka paraqitur ofertë.

4. "INERTI" SHPK NIPT: J66926804L

Vlera e ofertës pa TVSH: **14 588 091** (Katërmëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë.

5. B.O.E "INFINIT" SHPK, NIPT: J74304623M & "K.TURJA" SHPK, NIPT:

K81314014A

Vlera e ofertës pa TVSH: **18 790 435** (Tetëmbëdhjetë milion e shtëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekë.

6. B.O.E "KRONOS KONSTRUKSION" SHPK, NIPT: K41416033P & "A.L-ASFALT" SHPK, NIPT: K81511508A.

Vlera e ofertës pa TVSH: **17 475 450.8** (Shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë tetë) lekë.

7. "LEON KONSTRUKSION" SHPK **NIPT:**

K71820009I

Vlera e ofertës pa TVSH: **20 307 089.42** (Njëzet milion e treqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e nëntë pikë dyzet e dy) lekë.

8. "REJ" SHPK **NIPT:**
J93711608Q

Vlera e ofertës pa TVSH **19 730 193** (Nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

9. SIRETA 2F SHPK **NIPT:**
K51501008J

Vlera e ofertës pa TVSH **19 999 999** (Nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

10. B.O.E "SHENDËLLI" SHPK, NIPT: K07924803N & "JODY" SHPK, NIPT: J94824803M

Vlera e ofertës pa TVSH **18 219 272** (Tetëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

11. Vllaznia Ndërtim I.S SHPK **NIPT:**
K77524909Q

Vlera e ofertës pa TVSH **22 496 251** (Njëzet e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) lekë.

12. ZEQILLARI Shpk **NIPT:**
L61912024O

S'ka paraqitur ofertë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **B.O.E "ADA – CO" SHPK, Nipt: K64112603J & "KUARCI BLACË" SHPK NIPT: K24207608A.**

2. **"AURORA KONSTRUKSION" SHPK NIPT: K0201700I**

3. **"ELDA – VL" SHPK NIPT: K67106202Ë**

4. **"INERTI" SHPK NIPT: J66926804L**

5. **B.O.E "INFINIT"SHPK, NIPT: J74304623M & "K.TURJA" SHPK, NIPT: K81314014A**

6. **B.O.E "KRONOS KONSTRUKSION" SHPK, NIPT: K41416033P & "A.L-ASFALT" SHPK, NIPT: K81511508A.**

7. **"LEON KONSTRUKSION" SHPK NIPT: K71820009I**

8. **SIRETA 2F SHPK NIPT: K51501008J**

9. **B.O.E "SHENDËLLI" SHPK, NIPT: K07924803N & "JODY" SHPK, NIPT: J94824803M**

10. **Vllaznia Ndërtim I.S SHPK NIPT: K77524909Q**

12. **ZEQILLARI Shpk NIPT: L61912024O**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **"INERTI"**

SHPK, NIPT: J66926804L, rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

1. Nga dokumentacioni i paraqitur në sistem, operatori ekonomik **"INERTI" SHPK**, dëshmon se ka pjesë të stafit të vet **vetëm 1** punonjës (konstruktor metalik) dhe jo dy punonjës sipas kriterit 2.3.6.1 të DST, të ndryshuar.

2. Nga dokumentacioni i paraqitur në sistem, operatori ekonomik **"INERTI" Shpk**, nuk dëshmon se ka pjesë të stafit të vet nje koordinator për realizimin e punimeve i cili të disponojë diplomë universitare në inxhinieri, arkitekturë dhe gjithashtu certifikata për pjesëmarrjen në kurse specifike për sigurinë.

3. Tek Shtojca 1 Formulari i ofertës, oferta është shprehur vetëm me numra dhe jo me fjalë kjo në kundërshtim me LPP dhe VKM.

4. Kontratat e qirave të mjeteve të paraqitura janë të gjitha pa objektin e procedurës së prokurimit publik, kjo në kundërshtim me kriteret e vecanta për kualifikim.

5. Dëshmite e sigurimit Teknik të punonjësve të paraqitura me profesionet përkatëse të kërkuara në DST paraqesin parregullsi duke mos pasur asnjë element sigurie për vlefshmërinë e tyre asnje numërr serial apo aprovim firmë ose vulë nga trupa certifikuese, disa prej certifikatave janë paraqitur në kundërshtim me kriteret e vecanta për kualifikim pasi janë fotokopje dhe jo origjinale ose të njehsuara me origjinalin.

6. Pajisja e kerkuar në kriteret e veçanta për kualifikim Nivelues Lazer nuk është dëshmuar se disponohet nga shoqëria Inerti Shpk por është paraqitur pajisje helikopter nivelues i cili nuk është kerkuar në DST dhe nuk kryen funksionin e mjetit të kërkuar Nivelues Lazer, kjo sipas kriterit 2.3.7 të DST .

7. Fatura e TVSH-së e paraqitur për mjetin Tokmak me datë 13/08/2018, Nr.468 me Nr.serial 63649718 është fotokopje, as origjinale as kopje e njehsuar me origjinalin e vertetur . Në shtojcën 10 mbi disponimin e makinerive shoqëria Inerti Shpk ka deklaruar për mjetinn Tokmak që e disponon sipas faturës me sipër e cila është e parregullt sipas përshkrimit të mesipërm.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatori ekonomik "INERTI" Shpk me numër NIPT: J66926804L , skualifikohet.

B. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **Bashkimi i Operatorëve B.O.E. "ADA – CO" SHPK, Nipt: K64112603J DHE "KUARCI BLACË" SHPK, Nipt: K24207608A**, rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin Auto – Betoniere nga “Kuarci Blacë” Shpk ka vetëm një dokument zhdoganimit si dhe mjeti i paraqitur është Dumpër, dokumentacioni në fjalë është fotokopje, rrjedhimisht nuk plotëson pikën 2.3.7 të DST.

2. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin Kamiocinë nga “Kuarci Blacë” Shpk, polica e sigurimit është jashtë afatit (20.09.2019), pra nuk plotëson pikën 2.3.7 të DST:
3. Inxhinierit Elektrik i mungon librezja e punës të përcaktuar sipas pikës 2.3.6 të DST.
4. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin Fadromë nga Kuarci Shpk është me deklaratë doganore dhe jo me dokumentacion të vlefshëm sipas pikës 2.3.7 të DST.
5. Dokumentacioni i paraqitur nga “Kuarci Blacë” Shpk lidhur me punën e ngjashme ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme sipas pikës 2.3 të DST.
6. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin Kamion me vinc nga “Kuarci Blacë” afati i kontrollit teknik është 14.09.2019 si dhe nuk është i shoqëruar me foto, rrjedhimisht nuk plotëson pikën 2.3.7 të D.S.T:
7. Dokumentacioni i paraqitur për punonjësit Inxhinier, Gjeodet, Arkitekt nga “Kuarci Blacë” Shpk ka mungesa (diploma, librezja e punës, CV)
8. Dokumentacioni i paraqitur lidhur me certifikatat, mungon Certifikata PAS 99 -2012 (Sistemi i integruar i menaxhimit të shoqërisë “Kuarci Blacë” Shpk, pra nuk plotëson kriterin 2.3.3, të ndryshuar.
9. Dokumentacioni i paraqitur nga “ADA –CO ” Shpk lidhur me punën e ngjashme ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme sipas pikës 2.3 të DST.
10. Bilancet e paraqitura nga "Kuarci Blacë" Shpk nuk janë të plota si dhe mungojnë auditet.
11. Certifikatat e paraqitura për punonjësit janë fotokopje dhe nuk është paraqitur kontrata përkatëse për këta punonjës.
12. Fatura e paraqitur për pajisjet e sigurisë dhe ndihmës së shpejtë është fotokopje.
13. Dëshmitë e paraqitura për punonjësit e kualifikuar janë fotokopje dhe pa kontratat përkatëse sipas kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6.1, të ndryshuar.
14. Inxhinierit të ndërtimit nga "Kuarci Blacë" Shpk dokumentacioni është i pa plotë, kontrata e punës jo noteriale, librezja e punës dhe CV. (sipas kriterit në DST 2.3.6)
15. Inxhinierit Hidroteknik i paraqitur nga ADA Co Shpk dokumentacioni është fotokopje dhe kontrata pa akt noterial.
16. Dokumentacioni i paraqitur “Kuarci Blacë” Shpk për mjek të përgjithshëm sipas pikës 2.3.4 është fotokopje (kontrata, diploma).
17. Në kontratën e bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë 70% të punimeve, si rrjedhojë për periudhën e kërkuar Gusht 2018 - Gusht 2019 në DST duhej të kishte të punësuar të pakten 42 punonjës numër mesatar. ADA - Co ka numërr mesatar për periudhën Gusht 2018-Gusht 2019

vetem 8 punonjës. Pra, nuk plotëson numrin e kërkuar të punonjesve në raport me % e marre persiper në kontratën e bashkëpunimit.

18. "Kuarci Blacë" Shpk si pas Ekstraktit të QKB që ka paraqitur, vendet e tjera të ushtrimit të Aktivitetit ka në qytetin e Prrenjasit, Librazhdit dhe për vitin 2018 në qytetin e Durrësit. Për keto njesi nuk kaparaqitu rvertetim per mospasje detyrimesh per taksat vendore per vitin 2018 por ka paraqitur vertetim vetem nga Bashkia Pogradec, kjo në kundërshtim me kriteret e vecanta për kualifikim.

19. Tek Shtojca 1 Formulari i ofertës, oferta është shprehur vetëm me numra dhe jo me fjalë kjo në kundërshtim me LPP dhe VKM.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Bashkimi i Operatorëve B.O.E. "ADA – CO" Shpk Nipt: K64112603J DHE "KUARCI BLACË" Shpk Nipt: K24207608A, Skualifikohet.

C. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "**AURORA KONSTRUKSION**" SHPK, NIPT: **K0201700I** rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrojmë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin me targë TR 4592 (kontrata është pa objektin përkatës, dokumentacioni i pa noterizuar si dhe siguracioni i mjetit është i pavlefshëm (08.10.2019), rrjedhimisht nuk plotëson kriterin 2.3.7 të ndryshuar në DST.

2. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin Kamioncinë polica e sigurimit është jashtë afatit (12.10.2019), kontrata pa objektin përkatës rrjedhimisht nuk plotëson kriterin 2.3.7 të ndryshuar në DST.

3. Për punonjësën Specialist ndërtimi dëshmia e e kualifikimit shprehet për murator dhe jo specialist ndërtimi sipas pikës 2.3.6.1 të ndryshuar në DST.

4. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin me targë TR 4592 (kontrata është pa objektin përkatës, dokumentacioni i pa noterizuar si dhe siguracionii mjetit është i pavlefshëm

5. Mjeti kamiocinë me targë AA 289 MO kontrata pa objektin përkatës.

6. Kontrata e mjeteve Rafaelo 2002 (mjetet me targa AA 310 NS dhe AA 921 LO fotot të pa dallueshme).

7. Dokumentacioni për punonjësën A. Gjylbegaj (edhe koordinatore e sigurisë dhe konstruktor metalik)

8. Mungojnë punonjësit (konstruktor metalik) sipas kriterit 2.3.6.1 të DST.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatori ekonomik "AURORA KONSTRUKSION" SHPK, NIPT: K0201700I , u skualifikua.

Ç. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “ELDA – VL” Shpk NIPT: K67106202Ë rezultoi se nuk ka paraqitur ofertë dhe asnjë dokumentacion tjetër me kriteret e DST.

D. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **Bashkimi i Operatorëve B.O.E “INFINIT” Shpk NIPT: J74304623M DHE “K.TURJA” Shpk NIPT: K81314014A** rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrojmë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori lidhur me certifikatat e ndihmës së shpejtë dëshmon se është në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe sipas kriterit të përcaktuar në DST.

2. Mungon koordinatori për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shendetit.

3. Dokumentacioni i paraqitur për punonjësit e kualifikuar sipas pikës 2.3.6.1 në DST nuk plotëson kushtin për kontratat individuale të punës.

4. Mungon deklarata që Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikim për mjetet si nga shoqëria “INFINIT” Shpk dhe nga shoqëria K- TURJA Shpk.

5. Dokumentacioni i paraqitur në sistem për Inxhinier Elektrik i mungon librezja e punës.

6. Dokumentacioni i paraqitur në sistem për Inxhinier Ndërtimi kontrata e punës nuk është noteriale sipas pikës 2.3.6 në kriteret e DST.

7. Kontrata e bashkëpunimit mungon ndarja konkret e zërave të preventivit, kjo në kundërshtim kjo me LPP dhe me VKM Nr.914 datë 28.12.2014, të ndryshuar.

8. Kontrata e fadromës me targe AFMT14 pa objektin përkatës të kontraktimit.

9. Për punonjësin e paraqitur Arkitekt nuk gjendet në listpagesë.

10. Dokumentacioni i paraqitur për Mjetin mini fadromë nuk është paraqitur foto.

11. Dokumentacioni i paraqitur për punë të ngjashme - Faturat janë fotokopje si dhe mungon formular vleresimi sipas shtojcës 9 të kerkuar në Dokumentat Standarte te tenderit (Shoqëria Infinit)

12. Puna e ngjashme për shoqërine K- TURJA është « *Rikonstruktion Rruge.* »

13. Mungon vërtetimi i taksave vendore 2018 nga Bashkia Korçë- INFINIT shpk për të cilën ka paraqitur punën e ngjashme për vitin 2018 ndërtim me subjektin Privat ARNA shpk.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “INFINIT” Shpk NIPT: J74304623M , skualifikohet.

DH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **Bashkimi i Operatorëve B.O.E "KRONOS KONSTRUKSION" Shpk NIPT: K41416033P DHE "AL-ASFALT" SHPK NIPT: K81511508A** rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i paraqitur sistem për mjetët Autopompë + Auto Betoniere polica e sigurimit rezulton jashtë afatit (05.08.2019) rrjedhimisht nuk plotëson kriterin 2.3.7 në DST.
2. Dokumentacioni i paraqitur sistem nga shoqëria Al Asphalt për punë të ngjashme është "Rikualifikim rrugësh".
3. Dokumentacioni i paraqitur në sistem për punonjësin Elektricitist nga "Kronos Konstruksion" rezulton pa dëshmi kualifikimi.
4. Dokumentacioni i paraqitur për mjetin Fadromë (Kronos Konstruksion) është paraqitur pa foto.
5. Mungon deklarata për punonjësit (Kronos Konstruksion) për të cilët duhet të deklarohet disponueshmëria për realizimin e kontratës.
6. Kontrata e bashkëpunimit mungon ndarja konkrete e zerave të preventivit, në kundërshtim kjo me LPP dhe me VKM Nr.914 date 28.12.2014.
7. Formulari i ofertës vlera shprehet vetëm me numra dhe jo me fjalë kjo në kundërshtim me LPP dhe me VKM Nr.914 date 28.12.2014.
8. Dokumentacioni i paraqitur sa i përket shoqërisë Al – Asphalt për punonjësit e kualifikuar nuk ka të paraqitura kontratat për secilin punonjës, gjithashtu nuk janë paraqitur kontratat edhe për Specialistin e sigurisë në punë dhe punonjësit e ndihmës së parë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Bashkimi i Operatorëve B.O.E "KRONOS KONSTRUKSION" Shpk NIPT: K41416033P DHE "AL-ASFALT" SHPK NIPT: K81511508A: skualifikohet.

E. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **"ZEQILLARI" Shpk NIPT: L61912024O**, rezultoi se nuk ka paraqitur ofertë dhe asnjë dokumentacion tjetër me kriteret e DST.

Ë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **"LEON KONSTRUKSION" Shpk NIPT: K71820009I**, rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

1. Dokumentacioni i paraqitur në sistem lidhur me specialistin e ndërtimit dëshmia e kualifikimit e ka për specialist druri kjo si rrjedhojë nuk plotëson kriterin 2.3.6.1 të ndryshuar në DST.
2. Për mjetin kamioncine me targë AA 224 KL kontrata nuk përmban objektin e prokurimit.

3. Për mjetin Autobetoniere me targë GJ 1124 B kontrata nuk përmban objektin e prokurimit gjithashtu dhe fotoja e paraqitur për këtë mjet nuk është e qartë për të parë është mjet autobetoniere ose jo.

4. Tek dokumentacioni i Arkitektit mungon CV.

5. Tek dokumentacioni i Inxhierit të Ndertimit mungon kontrata noteriale e punës.

6. Mjeti fadrome me goma me targë AA 904 JA kontrata nuk përmban objektin e prokurimit.

7. Per mjetin kamioncine me targë AA 437 RB kontrata nuk përmban objektin e prokurimit.

8. Është paraqitur vetem 1 punonjës për ndihmën e parë i cili kontraten e ka me profesionin shofer, nga 2 punonjës të kërkuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK, NIPT: K718200091, U skualifikua.

F. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **Bashkimi i Operatorëve B.O.E "SHENDËLLI" Shpk, NIPT: K07924803N DHE "JODY" SHPK, NIPT: J94824803M**, rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrojmë si më poshtë:

1. Nga dokumentacioni i paraqitur në sistem, operatori ekonomik nuk dëshmon se ka pjese të stafit të vet ose të kontraktuar nje ë për realizimin e punimeve i cili të disponojë diplomë universitare në inxhinieri, arkitekturë dhe gjithashtu certifikata për pjesëmarrjen në kurse specifike për sigurinë.

2. Kontrata (Jody) Rikonstruksion Ura i aksit rrugor Ura e Gajdarit – Hyrja e Sarande – punë jo e ngjashme.

3. Mungojnë konstruktor metalik (shprehet në dokumentacion për konstruktor metalik por punonjësit në dëshmi kualifikimi janë saldatorë) rrjedhimisht nuk plotëson pikën 2.3.6.1 në DST.

4. Kontrata e qirasë e kamioncines AA 283 TS pa objektin e procedurës të prokurimit.

5. Kontrata e qirasë e kamioncines AA795TS pa objektin e procedurës të prokurimit.

6. Kontrata e qirasë e Autovincit pa objektin e procedurës të prokurimit.

7. Fadroma e paraqitur kontrata pa objekt si dhe parregullsi në kontrate ku shoqëria qiradhënëse është Halili shpk por kontrata është e firmosur nga FLED shpk.

8. Fadromë nga Shoqëria Kodheli kontrata eshte pa objektin e procedurës për prokurim

9. Fadroma me goma e paraqitur është me deklarate doganore.

10. Mungon deklarata qe Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë mjetet e paraqitura.

11. Tek Libreza e punës e mjekut të paraqitur mungon plotësimi në libreze nga JODY shpk që të

vertetoje punesimin e mjekut pranë kesaj shoqërie.

12. Të dyja shoqëritë nuk kanë paraqitur pajisjen **Nivelues Laser**, por nivelues të thjeshtë në faturat tatimore.

13. Formulari i ofertës vlera shprehet vetëm me numra dhe jo me fjalë kjo në kundërshtim me LPP dhe me VKM Nr.914 date 28.12.2014, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Bashkimi i Operatorëve B.O.E "SHENDËLLI" SHPK, NIPT: K07924803N DHE "JODY" Shpk, NIPT: J94824803M, u skualifikua.

G. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **"SIRETA 2F" SHPK, NIPT: K51501008J**, rezultoi se kishte mangësi të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

1. Mungojnë konstruktorë metalik sipas pikës 2.3.6.1 të ndryshuar në DST.
2. Murator është paraqitur vetëm 1 me kontratë përkatëse, ndërsa specialistët e tjerë murator i kane kontratat për specialist ndërtimi) ku sipas kriterit 2.3.6.1 të ndryshuar në DST duhen 4 punonjës murator të kualifikuar.
3. Punonjësi me profesion Arkitekt, kontrata e lidhur jo noteriale spas kriterit 2.3.6 në D.S.T.
4. Mungon pajisja nivelues laser (janë paraqitur dokumenta për nivelues, por 1 është nivelues asfalti dhe fatura e tvsh e paraqitur eshte set pajisjesh për matje dhe jonivelues laser)
5. Specialistët për dhënie e ndihmës së parë janë inxhinierë dhe të pajisur me certifikatën e përgjegjesit të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, jo punonjes të kualifikuar për dhënie e ndihmës së shpejtë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatori ekonomik "SIRETA 2F" Shpk, NIPT: K51501008J, u skualifikua.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.10.2019.

Ankesa: PO

Më datë 01.11.2019, pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "SHENDËLLI SHPK", e protokolluar me nr. 7626 prot.

Në përgjigje të ankesës, me vendimin Nr. 286, datë 07.11.2019, Komisioni i Autorizuar per Shqyrtimin e Ankeses, ka vendosur te mos pranojë ankesen dhe kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne KPP brenda 10 diteve, duke filluar nga dita e neserme e punes qe ankimuesi merr njoftimin.

Më datë 04.11.2019, pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "INFINIT SHPK", e protokolluar me nr. 7676 prot.

Në përgjigje të ankesës, me vendimin Nr. 288, datë 11.11.2019, Komisioni i Autorizuar për Shqyrtimin e Ankeses, ka vendosur të mos pranojë ankesën dhe kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KPP brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës që ankuesi merr njoftimin.

Ankesa në KPP: JO.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Operatorin Ekonomik REJ SHPK me numër NIPT: J93711608Q* dhe adresë sipas ekstraktit të QKB-së "Fshati Udenisht, ambient me numer pasurie 203/1, zona kadastrale 3665, Pogradec", se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH prej **19 730 193** (Nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *bashkisë Pogradec, personi përgjegjës*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (Pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik, në sistemin e APP-së, SPE, rubrika e mesazheve.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet siç parashikohet në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.10.2019.

Ankesa: PO

Më datë 01.11.2019, pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "SHËNDËLLI SHPK", e protokolluar me nr. 7626 prot.

Në përgjigje të ankesës, me vendimin Nr. 286, datë 07.11.2019, Komisioni i Autorizuar për Shqyrtimin e Ankeses, ka vendosur të mos pranojë ankesën dhe kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KPP brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës që ankuesi merr njoftimin.

Më datë 04.11.2019, pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "INFINIT SHPK", e protokolluar me nr. 7676 prot.

Në përgjigje të ankesës, me vendimin Nr. 288, datë 11.11.2019, Komisioni i Autorizuar për Shqyrtimin e Ankeses, ka vendosur të mos pranojë ankesën dhe kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KPP brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës që ankuesi merr njoftimin.

Ankesa në KPP: JO.

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]
ILIR XHAKOLLI**